



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 151, datë 22.12.2022

PËR
MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE
2023-2025 NË BASHKINË DURRËS

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar; Ligjit Nr.121/2016, datë 24.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2023-2025 në Bashkinë Durrës sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dymishi



U shpall sot me datë 27.12.2022



PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2023 - 2025

Përgatitur nga Bashkia Durrës
në kuadër të zbatimit të
Kartës Evropiane për Barazi
të grave dhe burrave në jetën vendore

Dhjetor, 2022



TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE.....	3
I. HYRJE	4
II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL	7
III. ARRITJET DHE VËSHTIRËSITË NGA ZBATIMI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2018-2020	10
IV. METODOLOGJIA	12
V. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHÝRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË	14
VI. KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2023 - 2025	18
VII. RAPORTIMI DHE MONITORIMI	22
VIII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2023 - 2025	23



LISTA E SHKURTIMEVE

AGK	Aleanca e Grave Këshilltare
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DAKRSKF	Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komuniteteve Fetare
DB	Drejtoria e Buxhetit
DBNJ	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
DPKZHT	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
DT	Drejtoria e Turizmit
DTV	Drejtoria e Taksave Vendore
DSHP	Drejtoria e Shërbimeve Publike
DSHS	Drejtoria e Shërbimeve Sociale
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DHF	Dhuna në Familje
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisiplinar (për rastet e dhunës në familje)
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial (për rastet e abuzimit të fëmijëve)
KB	Këshilli Bashkiak
KBGJ	Komisioni për Barazinë Gjinore
KBRE	Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës
KV	Koordinatore/Koordinator Vendor kundër dhunës në familje
LGBTI+	Persona lezbiike, gej, biseksuale/ë, transgjinore/ë, transseksuale/ë, interseks dhe cilëtdo persona të tjerë orientimi seksual dhe/ose shprehja e identitetit gjinor të të cilave/ëve është i ndryshëm nga heteroseksualet/ët.
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGJ	Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore
NJA	Njësi Administrative
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OS	Objektiv Specifik
PVVBGJ	Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030)
STI	Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit
UAMD	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak



I. HYRJE

Durrësi, është një ndër qytetet me histori të pasur kulturore në Shqipëri, që daton prej shekujve XIII-XI Para Krishtit. Një ndër simbolikat e arkeologjisë së këtij qyteti është mozaiku i famshëm i "Bukuroshes së Durrësit", zbuluar në vitin 1918 e që daton në shekullin e IV Para Krishtit. Fisnikeria e fytyrës së vajzës së Mozaikut dhe harmonia me të cilën ajo ndërthuret me lulet dhe pjesëzat që e rrethojnë, flet mjaft për atë që Durrësi mbart dhe transmeton: një qytet me tradita e kulturë, ku vajzat, të rejet dhe gratë, vlerësohen dhe respektohen për rolin e tyre të pazëvendësueshëm në të gjitha fushat e jetës, në familje e shoqëri.

Bashkia Durrës, është e para bashki në Shqipëri që hapi një zyrë të mirëfilltë për barazinë gjinore rrëth 14 vite më parë, duke u bërë kështu model për shumë bashki të tjera në vend. Bashkia Durrës renditet gjithashtu ndër të parat bashki në vend që kanë ngritur Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare (prej vitit 2009), apo dhe ndër pesë bashkitë e para që kanë nënshkruar Kartën Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, në 16 mars 2017, duke e pasuar këtë nënshkrim edhe me përgatitjen dhe miratimin në Këshillin Bashkiak, të Planit të parë Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020.

Gjatë tërmetit të vitit 2019, Bashkia Durrës ishte një nga ato Bashki që u godit rëndë e pësoi edhe humbje njerëzore, ndërkohë që gjatë vitit 2020 si në mbarë vendin e botën, Bashkisë iu desh të përballej me luftën kundër Covid-19, si dhe me vështirësitë e shtuara sa u takonte familjeve të dëmtuara nga tërmeti. Ndaj dhe dy vitet që lamë pas, kanë qenë vite sfidash të jashtëzakonshme për këtë Bashki, që nuk i ndërpren për asnjë moment shërbimet në funksion të qytetareve dhe qytetarëve të saj, pavarësisht njësisë administrative ku jetonin, apo grupit të cenueshëm të cilit i përkisnin. Por, duhet thënë që këto vështirësi e sfida kanë pasur ndikimin e tyre si në zbatimin e plotë të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020, ashtu edhe në vijimin e punës përgatitjen dhe miratimin e Planit të dytë Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore. Megjithatë, këto dy vite i shërbyen bashkisë që paralelisht me monitorimin e pjesshëm të zbatimit të objektivave të planit të mëparshëm, të evidentonte dhe nevojat kryesore të grupeve të caktuara për t'i adresuar në mënyrën e duhur në proceset e planifikimeve e buxhetimeve të vazhdueshme.



Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2023 – 2025 u përgatit nga Bashkia Durrës, si mjet kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore¹. Ky plani i dytë veprimit u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, Këshillin Rinor, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtarë e anëtarë të Këshillit Bashkiak. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Shqipëri në kuadër të Projektit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri: "Zbatimi i Kuadrit Ligjor (Acquis) të Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore" (EU4GE), që po zbatohet nga UN Women dhe UNFPA dhe financohet nga Bashkimi Evropian, përmes Fondit të Përshpejtimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

¹ Teksti i Kartës në gjuhën shqipe mund të aksesohet në:

https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjoints/filename/charter_equality_al.pdf

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesht kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).²

Sikurse përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të përparojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve vendorë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave³, të reja dhe të rinxve⁴, vajzave dhe djemve⁵. Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes vendore.

Për të adresuar më mirë shqetësimet në lidhje me dhunën me bazë gjinore e dhunën në familje, Bashkia Durrës filloi të shtojë numrin e Koordinatoreve Vendore kundër dhunës në familje edhe në nivel të Njësive Administrative (siç është rasti për NJA Sukth). Ndërkohë që gjatë punës për përgatitjen e këtij Plani të dytë Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako, vendosi të bëjë ndarjen e pozicionit të Nëpunëses së Barazisë Gjinore nga ai i Koordinatores Vendore kundër dhunës në familje, duke caktuar një specialiste të Sektorit të Planifikimit Strategjik, Standardeve e Monitorimeve Sociale dhe Shëndetit Publik, për të mbuluar detyrën e Nëpunëses së Barazisë Gjinore. Ndarja e këtyre dy pozicioneve dhe për më tepër vendosja e pozicionit të Nëpunëses së Barazisë Gjinore në një tjetër sektor, jashtë Sektorit të Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, është shumë domethënës, pasi bën të mundur pikërisht zbatimin e përgjegjësive të pozicionit së Nëpunëses së Barazisë Gjinore. Ndarja e këtyre dy pozicioneve dëshiron që Koordinatorja Vendore kundër dhunës në familje fokusohet tek menaxhimi i rasteve dhe natyrshëm është pjesë e Sektorit të Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, Nëpunësja e Barazisë Gjinore i jep jetë integrimit gjinor në proceset planifikuese, monitoruese e shumë më gjerë, si pjesë e Sektorit të Planifikimit Strategjik, Standardeve e Monitorimeve Sociale dhe Shëndetit Publik. Me miratimin dhe fillimin e zbatimit të këtij Plani Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, ky pozicion i Nëpunëses së Barazisë Gjinore do jetë me kohë të plotë dhe i dedikuar për këtë qëllim.

² Për një listë më të plotë me koncepte mund të viziton edhe: <https://eige.europa.eu/thesaurus/browse>

³ "Gra dhe burra" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshere duke filluar nga mbi 35 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).

⁴ "Të reja dhe të rinx" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshere nga 18 - 35 vjeç.

⁵ "Vajza dhe djem" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshere nga 0 - 18 vjeç.

Pavarësisht ndërhyrjeve dhe përmirësimëve të vazhdueshme, me gjithë përpjekjet e bëra apo që vijojnë të bëhen ndër vite për përparimin drejt barazisë gjinore, si dhe plotësimin e harmonizimin e kuadrit ligjor dhe të politikave vendore me ato kombëtare e ndërkombëtare, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e steriotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes vendore të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikat e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinxave, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin tonë ekonomik dhe shoqëror.

PVVBGJ 2023-2025 është konceptuar dhe lidhur logjikisht me nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, me planin e mëparshëm të veprimit për barazinë gjinore⁶, përfshirë vështirësitë apo sfidat e ndeshura për zbatimin e tij, me kuadrin ligjor dhe të politikave kombëtare, si dhe instrumentat kryesorë ndërkombëtarë të ratifikuar nga shteti shqiptar lidhur me barazinë gjinore. Sikurse është theksuar që në planin e mëparshëm 2018-2020, përparimi në këtë drejtim nënkupton përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha planet dhe dokumentet e zhvillimit të bashkisë. Por në ndryshim nga plani i mëparshëm, në këtë PVVBGJ 2023-2025, veprimet që trajtojnë çështjet gjinore të ndërthurura në planet dhe dokumentat e tjerë të bashkisë, nuk janë bërë pjesë e matricës së këtij plani veprimi. Në vend të tyre është parashikuar vlerësimi i ndikimit gjinor të këtyre ndërhyrjeve, si dhe përgatitja e mëtejshme e dokumentave të tillë duke përdorur lente gjinore. Ky ndryshim ndërmjet dy planeve synon pikërisht përgatitjen e bashkisë për të avancuar në planifikim, zbatim, monitorim e vlerësim të të gjitha ndërhyrjeve të saj, nën këndvështrimin gjinor, duke mundësuar gjithashtu një dokumentim sa më të mirë të rezultateve të matura me tregues të mirë përcaktuar e të ndjeshëm gjinorë. Kjo do të ndihmojë njëkohësisht edhe në mbajtjen e të dhënave të përditësuara e të ndara jo vetëm në bazë të seksit, por edhe të moshës, vendbanimit, etnisë, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual dhe shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, statusit të emigrantes / emigrantit apo azilkërkueses / azilkërkuesit, në bazë të problemeve të ndryshme sociale që mund të përjetojnë, etj.

Asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson sëç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinxave, vajzave e djemve, pra të të gjithë anëtarëve dhe anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave, mbetet një ndër synimet kryesore, për përbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithë përfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PVVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja “**nga të gjithë grupet**”, që të theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të të gjithë individëve, e në mënyrë të veçantë, të grave, të rejave dhe vajzave në tërsi, përfshirë edhe

⁶ Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020, miratuar në Këshillin Bashkiak në mars 2018.

nga grupe të ceneseshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuara, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj., pra nga të gjithë grupet në shoqëri.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PVVBGJ 2023 – 2025, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse⁷ dhe institucionet e organizatat⁸ partnerë në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit përkatës dhe dokumentat kryesorë ku mbështeten hapat e planifikuar.

II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Nën nenin 18 të kushtetutës qartësohet shprehimi se: “1. Të gjithë janë të barabartë përpëra ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tillë si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare o filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.”. Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentash ndërkombëtarë, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zënë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohem parashikimeve në instrumentat ndërkombëtarë të ratifikuar.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2023 - 2025 përvèçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, mbështetet në një tërësi dokumentash të rëndësishëm ligjorë dhe institucionale, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

a) Instrumente ndërkombëtarë

⁷ Pavarësisht se në matricën e PVVBGJ janë cituar Drejtoritë përgjegjëse (pra jo në nivel drejtorie të përgjithshme), kuptohet që përgjegjës kryesor për zbatimin e aktivitetit është si Drejtoria e cituar ashtu edhe vetë Drejtoria e Përgjithshme, në varësi të së cilës është secila drejtori e cituar si përgjegjëse apo mbështetëse për zbatim.

⁸ Duke qenë se Bashkia Durrës synon rritjen dhe fuqizimin e partneriteteve me OFJ të specializuara në fusha të ndryshme, për të mos pasur një listë shteruese të tyre, është përdorur kryesisht termi “OFJ të specializuara” dhe nuk janë përmendor emrat e organizatave partnerë. Përashtime bëhet vetëm në rastet kur këto organizata finançoohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga bashkia, apo janë angazhuar për zbatimin direkt të një aktiviteti përmes një marrëveshjeje me bashkinë dhe e kanë të siguruar burimin financiar për këtë qëllim.

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality).⁹
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA).
- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, etj.

b) Kuadri ligjor kombëtar

- Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligji Nr. 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar¹⁰.
- Ligji Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligji Nr. 104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
- Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Ligji Nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin”.
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”.
- Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”.

⁹ E renditur në krye të kësaj liste për shkak të rëndësisë që ka në nivelin vendor në lidhje me vetë përgatitjen e këtij PVVBGJ. Ndonëse ky dokument nuk është i ratifikuar nga shteti shqiptar, sepse nuk ka një procedurë të tillë, pjesëmarrja në të bëhet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e vetë bashkive.

¹⁰ Së bashku me Ligjin Nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, si dhe me të gjithë ndryshimet e mëparshme që ka pësuar ligji bazë Nr. 9669/2006.

- Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”, etj.

c) Politikat kombëtare

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2023 – 2025 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitet apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoret) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030¹¹.

d) Institucionet përgjegjëse

Sic përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, të cilat/cilët përveçse brenda institucionit të tyre raportojnë, sipas kërkesës, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Bashkia Durrës ishte bashkia e parë në Shqipëri që hapi Zyrën për Barazinë Gjinore 14 vite më parë. Me ngritjen e Mekanizmit të Koordinuar të referimit kundër dhunës në familje në vitin 2009, Nëpunësja e Barazisë Gjinore ka mbajtur edhe pozicionin e Koordinatores Vendore kundër Dhunës në Familje dhe nisur nga numri i rasteve të dhunës dhe zonave më të prekura, Bashkia e plotësoi këtë pozicion, edhe me një tjetër Koordinatore Vendore në një njësi administrative. Ndërsa, në kuadër të përgatitjes së këtij Plani të dytë Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, Bashkia vendosi të bëjë ndarjen e pozicionit të Koordinatores vendore nga Nëpunësja e Barazisë Gjinore, duke dedikuar për këtë të fundit një specialiste nga Sektori i Planifikimit Strategjik, Standardeve e Monitorimeve Sociale dhe Shëndetit Publik. Duke filluar nga viti 2023, ky pozicion do të jetë tërësisht me kohë të plotë dhe dedikuar vetëm çështjeve të barazisë gjinore.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin vendor luajnë edhe Aleanca e Grave Këshilltare dhe Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale në nivel të Këshillit Bashkiak. Po kështu me rëndësi është edhe formalizimi i një Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie i përbërë nga Drejtore/Drejtore të Drejtoreve përgjegjëse për zbatimin e këtij PVVBGJ, duke përfshirë jo vetëm ato/ata të cilat/cilët ishin edhe pjesë e grupit të punës që përgatiti këtë plan, por edhe të drejtoreve të tjera sipas nevojës. Ky Komision, do të mundësonë një zbatim akoma më të mirë të PVVBGJ-së edhe përshtata elementë që nuk janë të përmendur në mënyrë të detajuar në matricë, por që sic u theksua edhe më sipër, janë të domosdoshëm për përparimin në drejtim të fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave dhe arritjen e barazisë gjinore (p.sh. ky Komision do të mundësonë përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjithë dokumentat zhvillimore të bashkisë, pavarësisht sektorit apo çështjes që mbulojnë). Ndaj dhe formalizimi i këtij Komisioni për Barazinë Gjinore në nivel bashkie është një ndër hapat e parë të parashikuar për zbatim, menjëherë pas miratimit të PVVBGJ në Këshillin Bashkiak. Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe OJF të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave

¹¹ Miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021. Shiko: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx>

dhe veprimeve kryesore në këtë PVVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PVVBGJ.

III. ARRITJET DHE VËSHTIRËSITË NGA ZBATIMI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2018-2020

Sikurse u përmend edhe më sipër, Bashkia Durrës është një nga pesë Bashkitë e para nga gjithsej katërmëdhjetë bashki në vend, që nënshkroi Kartën Evropiane për Barazi dhe hartoit e miratoi Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, për periudhën 2018-2020. Zbatimi i PVVBGJ 2018-2020 duhet thënë që përkoi me një periudhë të shoqëruar me situata të paparashikuara. Gjatë tërmetit të vitit 2019, Bashkia Durrës ishte një nga ato Bashki që u godit rëndë e pësoi edhe humbe njerëzore, ndërkohë që gjatë vitit 2020 si në mbarë vendin e botën, Bashkisë iu desh të përballej me luftën kundër Covid-19, me vështirësitë e shtuara sa u takonte familjeve të dëmtuara nga tërmeti. Pavarësisht vështirësive të ndeshura si pasojë e këtyre situatave madhore, Bashkia Durrës ka mundur që të zbatojë një përqindje të lartë të masave dhe veprimeve të parashikuara në PVVBGJ 2018-2020.

Paralelisht me monitorimet e brendshme të realizuara nga vetë stafi i Bashkisë Durrës në lidhje me zbatimin e Planit të parë Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020, janë kryer edhe dy raporte monitorimi, konkretisht një me mbështetjen e UN Women, fokusuar në monitorimin e zbatimit të Objektivit Specifik 3.7 të këtij plani dhe një raport i përgatitur nga Shoqata "Gender, Paqe, Siguri" me mbështetjen e Rrjetit të Fugizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), edhe ky i fokusuar në Funksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, në Bashkinë Durrës.

Bazuar në këto dy raporte monitorimi, si edhe në monitorimin e brendshëm nga ana e vetë bashkisë, rezulton se gjatë periudhës 2018-2020, në kuadër të zbatimit të PVVBGJ 2018-2020 është arritur sa në vijim:

- Është përmirësuar ndjeshëm efektiviteti i funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje. Anëtarët dhe anëtarët e këtij Mekanizmi janë trajnuar vazhdimisht dhe punojnë së bashku në menaxhimin e rasteve. Megjithatë, nevojitet ende punë në këtë drejtim, së pari kur flitet përfuqizimin e kapaciteteve të profesionisteve / profesionistëve, pasi legjislacioni ndryshon dhe përmirësohet vazhdimisht. Gjithashtu, mbledhjet e Komitetit Drejtues dhe të Ekipit Teknik nuk realizohen plotësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mbledhjet e ETN janë më të rregullta, edhe pse jo gjithmonë në bazë mujore, ndërsa mbledhjet e Komitetit Drejtues janë më të rralla (një në vit) dhe në to vihet re pjesëmarrje e specialisteve/specialistëve të institucioneve anëtare në vend të drejtueseve/drejtuesve.
- Bashkia ka dedikuar burimet e duhura njerëzore në funksion të zbatimit më të mirë të legjislacionit e politikave për barazinë gjinore e kundër dhunës në familje. Siç edhe u shpjegua më sipër, pozicioni i Nëpunëses së Barazisë Gjinore dhe Koordinatores Vendore kundër dhunës në familje, fillimisht u mbështet me shtimin e një Koordinatoreje Vendore

në një nga njësitë administrative të Bashkisë Durrës, e më pas, gjatë fillimit të punës për përgatitjen e këtij PVVBGJ u bë edhe kalimi i përgjegjësive të Nëpunës së Barazisë Gjinore tek një tjetër specialiste, duke e ndarë përfundimisht këtë pozicion nga ai i Koordinatores Vendore.

- Sikurse dhe e kishte planifikuar në PVVBGJ 2018-2020, Bashkia Durrës në bashkëpunim me World Vision dhe me mbështetjen edhe të Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale përmes Fondit Social, ka të ngritur tashmë Qendrën për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente, për Fëmijën dhe Familjen.
- Të gjitha rastet e dhunës në familje që paraqiten pranë institucioneve anëtare të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në Durrës menaxhohen me sukses duke iu mundësuar shërbimet sipas nevojës, në bashkëpunim dhe partneritet edhe me OFJ e specializuara, apo organizatat ndërkombëtare.
- Bashkia Durrës ka një bashkëpunim shumë të mirë me organizatat e shoqërisë civile si: Qendra Komunitare "Sot për të Ardhmen", Shoqata "Gruaja, Paqja Siguria", "Qendra për Nisma Ligjore Qytetare", Qendra "Fokus në ndihmë të fëmijëve", World Vision dhe OFJ të tjera. Ky bashkëpunim ka rezultuar i frytshëm në ofrimin e shërbimeve, ndërtimin e kapaciteteve të aktorëve si edhe në punën ndërgjegjësuese, me qëllim parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
- Rolin kryesor në fushatat ndërgjegjësuese në Bashkinë e Durrësit e luajnë organizatat e shoqërisë civile që punojnë në territorin e bashkisë. Mbështetja financiare e bashkisë në lidhje me fushatat ndërgjegjësuese ka nevojë të forcohet. Bashkia Durrës nuk ka të përcaktuar në buxhetin e saj zë të veçantë për realizmin e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore, për publikimin e fletëpalosjeve ndërgjegjësuese apo materiale të tjera të ngjashme. Ky komponent është shumë i rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimit, rritjen e numrit të rasteve të raportuara si edhe ndarjen e informacionit me komunitetin mbi funksionimin e MKR së rasteve të dhunës në familje pranë kësaj bashkie, institucionet përgjegjëse dhe rolin e tyre.
- Bashkia i ka dhënë në përdorim, pa kundër shpërbirim, Qendrën për Zhvillim Komunitar "Sot për të ardhmen", dy ambiente pronë e bashkisë Durrës, për një afat kohor 3 vjet, për t'u përdorur "për shërbime dhe mbështetje sociale e kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore, për nisma në mbështetje të shërbimeve publike, arsimi, edukimi, punësimi e zhvillimi ekonomik dhe për informimin, ndërgjegjësimin, integrimin, bashkëjetësen komunitare dhe dialogun social. Kjo praktikë është identifikuar si një praktikë e mirë që rekomandohet të ndiqet nga të gjitha bashkitë në vend, sepse krijon mundësinë e qëndrueshmërisë në ofrimin e shërbimeve, si dhe forcon bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me organizatat e shoqërisë civile.
- Fakti që Bashkia Durrës parashikon në buxhetin e saj në mënyrë të përvitshme fonde që shkojnë për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat / të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, është tepër pozitiv, pavarësisht se nuk vërehet rritje në përqindje e kësaj shume, nga një vit në tjetrin.

Gjatë diskutimeve paraprake për përgatitjen e PVVBGJ 2023-2025, nga stafi i Bashkisë Durrës u renditën edhe disa çështje të rëndësishme për t'u konsideruar dhe bërë pjesë e planit, të tilla si:

- Vazhdimi i mbështetjes së funksionimit të Qendrës për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen (sidomos tani që përfundon marrëveshja tre vjeçare me MSHMS dhe mbështetja përmes Fondit Social jepet vetëm në masën 30%).
- Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave e Referimit të Rasteve (NJVNR) në nivel të Njësive Administrative.
- Përmirësimi i politikave të punësimit veçanërisht për të rejat dhe të rinjtë në bashkëpunim me Zyrat e Punës (ndërgjegjësim, takime, përmirësim të kurrikulave të formimit profesional, të sfiduarit e steriotipeve dhe roleve gjinore në punësim, etj.).
- Përgatitja e disa formave të unifikuara mbi të dhënat që duhet të mblidhen rregullisht, të ndara sipas gjinisë dhe karakteristikave të tjera individuale, etj.

Sa më sipër, përfshirë dhe diskutimet e zgjeruara në këtë drejtim gjatë përgatitjes e konsultimit të PVVBGJ 2023 – 2025, kanë udhëhequr parashikimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara në matricën e këtij plani, siç paraqitet në kapitullin VIII të tij.

IV. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVVBGJ 2022-2024 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk review).** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentash ekzistues apo draft dokumentash të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.
- **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshmës për t'u përfshirë në matricën e PVVBGJ 2022-2024.** Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, që filluan që nga vlerësimi i arritjeve dhe sfidave në zbatimin e PVVBGJ 2018-2020, identifikimi i prioriteteve bazuar në desk review të realizuar në fazën e parë, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e bashkisë, NJA-të dhe lagjet, si dhe nga partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të bashkisë (OJF, bizneset, media, UAMD, etj.).
- **Konsultimet paraprake brenda bashkisë.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësuese dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë në bashki), si dhe administratorët e NJA-ve. Ky hap u konsiderua i domosdoshëm, së pari për të mundësuar njojen me Kartën Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore për të gjitha/gjithë ata persona që nuk e kishin këtë informacion më herët (pra që mbajnë pozicione të caktuara në bashki por që nuk kanë qenë të pranishëm apo të angazhuar në procesin e njoftes me Kartën dhe përgatitjes së PVVBGJ 2018-2020), por edhe për të diskutuar me personat që kanë qenë pjesë e këtij procesi edhe më herët, mbi detaje që lidhen me formatin dhe përbajtjen në tërësi të PVVBGJ, sidomos pasi u përfshinë në zbatimin e tij.

- **Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2023 – 2025.** Drafti i përgatitur për konsultim përbante sektionet dhe të dhënrat kryesore, vizionin, fushat e ndërhyrjes, objektivat specifikë dhe masat e veprimet e parashikuara për arritjen e objektivave specifikë. Në këtë draft u reflektuan edhe ndryshimet e dakordësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.

- **Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit.** Ky proces u zhvillua mbi draft dokumentin e përgatitur. Në konsultime u përfshinë drejtoritë përgjegjëse dhe stafi brenda bashkisë, NJA-ve, OFJ-të bashkëpunëtore, si dhe anëtare të Aleancës së Grave Këshilltare dhe të Këshillit Bashkiak. Në dy konsultime kryesore të zhvilluara përkatesisht, një konsultim në datën 20 maj 2022 dhe një konsultim në datën 15 nëntor 2022 u përfshinë rreth 47 pjesëmarrëse e pjesëmarrës. Draft PVVBGJ 2023 – 2025 u qarkullua edhe nëpërmjet e-mailit në një numër të konsiderueshëm partnerësh e bashkëpunëtorësh (në 50 adresa e-maili), me qëllim dhënien e mundësisë për të pasur komentet e tyre dhe për ta zgjeruar maksimalisht procesin e konsultimit.

Po kështu, në datën 21 nëntor 2022, draft PVVBGJ u postua për konsultim publik edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, i aksesueshëm në:

https://www.durres.gov.al/images/Draft_PVVBGJ - Bashkia_Durres - nentor_2022.pdf

Procesi i konsultimit publik qëndroi i hapur deri në datën 15 dhjetor 2022.

- **Finalizimi i draft PVVBGJ 2023-2025 dhe kostimi i veprimeve të dakordësuara.** Finalizimi i draft PVVBGJ u bë në bazë të komenteve dhe sugjerimeve të marra gjatë konsultimit të tij. Paralelisht u realizua edhe kostimi i aktiviteteve të dakordësuara.

- **Miratimi i PVVBGJ 2023 – 2025 në Këshillin Bashkiak.** Versioni përfundimtar i PVVBGJ i konsultuar e kostuar u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak. Pas miratimit, PVVBGJ 2023 – 2025 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë, si dhe versioni anglisht i tij do të publikohet në faqen e Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE). Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2023-2025 i Bashkisë Elbasan, u miratua me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. xx datë xx.12.2022.

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë dhe me metodologjinë e përgatitjes së PVVBGJ-ve siç sugjerohet nga KBRE¹² dhe sigurisht janë aplikuar edhe gjatë përgatitjes së PVVBGJ 2018-2020 më herët nga Bashkia Durrës. Megjithatë, siç u përmend edhe në hyrje të këtij dokumenti, në ndryshim nga PVVBGJ 2018-2020, në këtë PVVBGJ 2023 – 2025 nuk janë vendosur edhe masat dhe veprimet e parashikuara në dokumenta të tjera të bashkisë përfusha të caktuara që shkojnë në linjë me plotësimin e neneve të ndryshme të Kartës. Në vend të tyre është specifikuar dhe do insistohet të përbushet së pari përfshirja e perspektivës gjinore në të gjithë këto plane që në momentin e përgatitjes së tyre, e së dyti do insistohet përvlerësimin e ndikimit gjinor të zbatimit të tyre, duke mundësuar kështu edhe një dokumentim e monitorim më të kujdeshëm të të gjithë veprimeve që në thelb synojnë zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi, pavarësisht nëse janë cituar apo jo ato veprime si pjesë e këtij PVVBGJ.

¹² Për më shumë shiko në: <https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html>

Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PVVBGJ ka luajtur mbështetja dhe asistenca teknike e ofruar nga UN Women, përmes një konsulenteje¹³ të angazhuar për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të Projektit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri: “Zbatimi i Kuadrit Ligor (Acquis) të Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore” (EU4GE), që po zbatohet nga UN Women dhe UNFPA dhe financohet nga Bashkimi Evropian, përmes Fondit të Përspektivës së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

V. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Vizioni:

“Gratë dhe burrat, të rejet dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Durrësit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantes/emigrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

Parimet¹⁴ që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, siç paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjithë grupet, përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

Fushat kryesore të ndërhyrjes.

